



Funded by
the European Union

Të kuptuarit e
kontekstit institucional:
**VLERËSIMI I DHUNËS ME
BAZË GJINORE NË KOSOVË**



Mirënjohje

“Të kuptuarit e kontekstit institucional: Vlerësimi i dhunës me bazë gjinore në Kosovë” është një studim bazë i realizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) në partneritet me Programin e Solidar Suisse për Evropën Juglindore, botuar në kuadër të programit të BE-së “Parandalimi i dhunës me bazë gjinore përmes edukimit dhe ngritjes së vetëdijes”, e menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky projekt është i përkushtuar për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në shoqërinë kosovare përmes edukimit dhe ngritjes së vetëdijes.

Hulumtuese: Nora Jusufi

Redaktore: Luljeta Demolli, Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Menaxhere e Hulumtimit: Alba Ajdarevikj, Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) www.kgscenter.net ka kontribuar në integrimin gjinor që nga viti 2002 dhe vazhdimisht mundohet që të arrijë barazinë gjinore në Kosovë. Ka qenë nismëtare e ndryshimeve ndaj sistemit diskriminues, normave shoqërore dhe standardeve të dyfishta brenda shoqërisë kosovare dhe është shumë aktive në monitorimin e institucioneve publike. Misioni i QKSGJ-së është integrimi i analizave, programeve dhe politikave të ndjeshme ndaj gjinisë në të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare duke rritur ndërgjegjësimin gjinor dhe duke u përqendruar në çështjet gjinore, zhvillimin e studimeve gjinore dhe sigurimin se ka përfshirje të politikave të ndjeshme gjinore përmes hulumtimit, zhvillimit të politikave, avokimit dhe lobimit.

Përgjegjësia

Ky publikim është i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbytja e tij është përgjegjësi e vetme e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

E drejta autoriale

© 2023 – Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ). Të gjitha të drejtat e rezervuara. Licencuar në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) me kushte.

TABELA E PËRMBAJTTJES

Lista e shkurtesave.....	3
Gjetjet kryesore.....	4
Hyrje.....	7
Përmbledhje e literaturës.....	9
Korniza Ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare.....	9
Hulumtimi ekzistues mbi dhunën me bazë gjinore në Kosovë.....	13
Funksionaliteti i Mekanizmave të Paralajmërimit të Hershëm Lokal dhe Shërbimeve të Ofruara për Përkrahjen e Viktimave në Kosovë.....	14
Mangësitë ekzistuese në literaturë dhe kontributi i studimit.....	17
Metodologjia.....	17
Gjetjet nga intervistat e thëlluara.....	18
Perceptimi dhe shkaqet e dhunës me bazë gjinore në Kosovë.....	18
Shpeshësia e ballafaqimit me raste të Dhunës me bazë gjinore, lehtësia e raportimit të të mbijetuarave dhe besimet e konfidencialitetit.....	19
Pengesat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.....	21
Nevojat e komunave për të zbatuar në mënyrë efektive Mekanizmat Koordinues Komunal...22	
Strategjitë për Parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë - Praktikat më të mira.....24	
Gjetjet e anketës.....	25
Profili demografik i të anketuarve.....	25
Perceptimi, niveli dhe shkaqet e dhunës me bazë gjinore në Kosovë.....	27
Shpeshësia e ballafaqimit me raste të dhunës me bazë gjinore, lehtësia e raportimit të të mbijetuarave dhe besimet e konfidencialitetit.....	29
Pengesat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.....	31
Nevojat e komunave për të zbatuar në mënyrë efektive Mekanizmat Koordinues Komunal...32	
Strategjitë për Parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë.....	36
Përfundime dhe rekomandime.....	40
Lista Referencave.....	45

LISTA E SHKURTESAVE

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KE	Këshilli i Evropës
ZKP	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
DhF	Dhuna në Familje
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
BGJ	Barazia gjinore
ZBGJ	Zyrtarët për Barazi Gjinore
KS	Konventa e Stambollit
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MKKDHF	Mekanizmat Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
QPS	Qendra për Punë Sociale
UN WOMEN	Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
DhNG	Dhuna ndaj Grave

GJETJET KRYESORE

Më poshtë janë përmbledhur gjetjet kryesore të nxjerra nga gjashtë intervista të realizura me Zyrtaret për Barazi Gjinore (ZBGJ), si dhe nga të dhënat e mbledhura nga anketa e realizuar me 51 përfaqësues të institucioneve publike. Të anketuarit mbanin pozita të ndryshme në institucione publike, përfshirë zyrtarë komunalë, deputetë, përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillit Prokuorial të Kosovës (KPK), Policisë së Kosovës, Qendrave për Punë Sociale dhe zyrtarë të departamenteve përkthënëse të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS).

Gjetjet kryesore nga intervistat janë përmbledhur më poshtë:

1. Perceptimet dhe shkaqet e dhunës me bazë gjinore:

- Dhuna me bazë gjinore perceptohet si shkelje e të drejtave themelore të njeriut
- Shkaqet e zakonshme të dhunës me bazë gjinore në Kosovë përfshijnë:
- Dhuna në familje brenda njërive të ngushta familjare (abuzimi psikologjik, fizik dhe ekonomik)
- Struktura shoqërore patriarkale dhe vlerat tradicionale kulturore
- Ndryshimi i qëndrimeve kulturore ndaj roleve gjinore gjatë periudhës së tranzicionit
- Mungesa e edukimit për të drejtat e grave
- Pasiguria ekonomike e grave dhe varësia nga bashkëshortët
- Ndikimi i abuzimit me substanca narkotike nga dhunuesit

2. Shpeshësia e ballafaqimit me raste të dhunës me bazë gjinore (DhBGJ) dhe lehtësia e raportimit:

- Perspektiva të ndryshme janë shfaqur rreth shpeshësisë së rasteve të dhunës me bazë gjinore të raportuara në komuna, duke filluar nga nivelet mesatare deri në ato të larta të raportimit të dhunës me bazë gjinore
- Perceptohet të ketë vështirësi në inkurajimin e të mbijetuarave për të raportuar rastet e dhunës me bazë gjinoredhunës me bazë gjinore për shkak të:
- Frikës nga pasojat dhe reagimet nga dhunuesit
- Mungesës së ndërgjegjësimit për procedurat e raportimit
- Konfidencialiteti konsiderohet i rëndësishëm, por shpesh rrezikohet për shkak të:
- Diskutimeve joformale për rastet jashtë punës nga zyrtarët përgjegjës
- Mungesës së anonimitetit në një shoqëri me mentalitet kolektiv

3. Pengesat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore:

- Shqetësimet për stigmën shoqërore dhe pasojat negative
- Vështirësi për të dëshmuar dhunën, veçanërisht abuzimin psikologjik
- Frika nga përjashtimi social dhe pamundësia për t'u riintegruar në shoqëri
- Shqetësimet e sigurisë për fëmijët dhe mos prishjes së harmonisë familjare
- Mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë dhe trajtimit të drejtë të rastit
- Varësia financiare nga dhunuesit që çon në kthim pas raportimit të tyre

4. Nevojat për zbatimin efektiv të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje (MKKDFH)
- Staf profesional me ndjeshmëri gjinore dhe reduktim të lënies së punës dhe ndërrimit të shpeshtë të stafit
 - Infrastruktura të përmirësuar, duke përfshirë mjaftueshëm automjete të policisë
 - Përkrahje financiare të shtuar për mekanizmat, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal
 - Bashkëpunim më i madh ndërmjet akterëve kryesorë, veçanërisht sistemit gjyqësor
 - Disponueshmëri e strehimoreve të përshtatshme, duke adresuar kufizimet për pranim në bazë të gjinisë dhe moshës së fëmijës
 - Krijimi i mundësisë për pajisjen e Mekanizmave Koordinues Komunal me fuqi vendimmarrëse dhe mundësimi i bashkëpunimit më të mirë ndërmjet institucioneve të Mekanizmave Koordinues Komunal
5. Strategjitë e rekomanduara për parandalimin e dhunës me bazë gjinore:
- Trajnim i stafit për konventat ekzistuese dhe ndërgjegjësimi i akterëve kryesorë
 - Trajnim i komunitetit për të njohur dhe raportuar incidentet e dhunës me bazë gjinore
 - Rehabilitim dhe përkrahje për dhunuesit për të adresuar shkaqet kryesore që çojnë tek dhuna
 - Bashkëpunim me qendrat e formimit profesional dhe zyrat e punësimit
 - Programe falas të trajnimit profesional për të mbijetuarat për të rritur punësueshmërinë e tyre
 - Përkrahje financiare dhe ndihmë për një periudhë të caktuar
 - Përmirësim i sistemit gjyqësor për trajtim të shpejtë dhe ndëshkim të drejtë të dhunuesve
 - Angazhim aktiv i të gjithë akterëve kryesorë për zbatimin efektiv të ligjeve

Gjetjet kryesore nga anketa janë përmbledhur më poshtë:

1. Profili demografik i të anketuarve:
- Përfaqësuesit komunalë përbënin 65% të të anketuarve, të ndjekur nga përfaqësuesit e Qendrës për Punë Sociale (14%) dhe zyrtarët e Policisë së Kosovës (8%).
 - Burrat përbënin 35% të të anketuarve, ndërsa gratë 65%.
 - Shumica e të anketuarve kishin diplomë Bachelor (49%), pasuar nga një diplomë Master (43%), dhe një përqindje më e vogël kishin përfunduar doktoraturën ose kishin nivel të arsimimit ekuivalent (4%).
2. Perceptimi, niveli dhe shkaqet e dhunës me bazë gjinore në Kosovë:
- Shumica e të anketuarve (51%) e perceptojnë nivelin e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) në Kosovë si mesatar, ndërsa 41% e konsiderojnë atë të lartë dhe vetëm 8% besojnë se është shumë i lartë.

- Varfëria dhe pasiguria ekonomike (31%), mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit (28%), qëndrimet kulturore ndaj roleve gjinore (23%) dhe sistemet e dobëta të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit (18%) u identifikuan si shkaqet kryesore të dhunës me bazë gjinore.
3. Shpeshësia e ballafaqimit me raste të dhunës me bazë gjinore, lehtësia e raportimit të të mbijetuarave dhe besimi mbi konfidencialitetin e raportimit:
- Shumica e të anketuarve raportuan se kishin hasur në raste të dhunës me bazë gjinore herë pas here (39%) ose rrallë (37%), ndërsa një përqindje e dukshme (24%) kishin hasur në raste të tilla shpesh.
 - Të mbijetuarat zakonisht i raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore në stacionin policor (96%) e jo në Qendrën për Punë Sociale (4%).
 - Raportimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore u perceptua si shumë i vështirë nga një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (35%), deri diku i vështirë nga 33%, deri diku i lehtë nga 22%, dhe shumë i lehtë vetëm nga 2% e tyre.
 - Shumica e të anketuarve (51%) i konsideronin kanalet e raportimit për rastet e dhunës me bazë gjinore si deri diku konfidenciale, ndërsa 31% i konsideronin ato shumë konfidenciale.
4. Pengesat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore:
- Mungesa e përfaqësimit ligjor (51%) dhe stigma sociale (24%) u identifikuan si sfidat kryesore me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.
 - Qasja e kufizuar në shërbimet mbështetëse (16%), frika nga hakmarrja (4%) dhe dëshmitë e pamjaftueshme (4%) u përmendën gjithashtu si pengesa.
5. Nevojat e komunave për të zbatuar në mënyrë efektive Mekanizmat Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje (MKKDFH)
- Edhe pse 63% e të anketuarve deklaruan praninë e mekanizmave të paralajmërimit të hershëm, 37% deklaruan mungesën e tyre, gjë që thekson nevojën për vëmendje më të madhe për krijimin e mekanizmave efektiv.
 - Mekanizmi Koordinues Komunal u perceptua si shumë efektiv nga 33% e të anketuarve, deri diku efektiv nga 31%, dhe joefektiv nga 10%.
 - Sfidat me të cilat përballen Mekanizmi Koordinues Komunal përfshinin mungesën e burimeve dhe financimit (41%), bashkëpunimin dhe koordinimin e kufizuar ndërmjet palëve të interesit (10%) dhe trajnim të pamjaftueshëm për ngritjen e kapaciteteve (14%).
6. Strategjitë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë:
- Shumica e të anketuarve (61%) besojnë se ka përkrahje të pamjaftueshme në dispozicion për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore në komunën ose institucionin e tyre.
 - Institucionet publike në Kosovë u perceptuan se e trajtojnë dhunën me bazë gjinore mesatarisht mirë nga 65% e të anketuarve.
 - Ndërsa 61% e të anketuarve ishin të vetëdijshëm për politikat ekzistuese ose hulumtimet në lidhje me parandalimin e dhunës me bazë gjinore, 39% nuk ishin në dijeni.

- Forcimi i sistemeve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit (20%), ofrimi i shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarat (19%), promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave (21%) dhe rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimit (20%) u identifikuan si hapa të rëndësishëm për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

HYRJE

Dhuna me bazë gjinore (DHBG) është temë e diskutimeve të gjera vitet e fundit. Ajo i referohet akteve të dhunës që synohen në mënyrë specifike ndaj disa individëve bazuar në gjininë e tyre ose dhunës që prek në mënyrë disproporcionale individët e një gjinie të caktuar, ku gratë zakonisht preken në mënyrë disproporcionale në krahasim me burrat. Dhuna ndaj grave njihet si shkelje e të drejtave të tyre njerëzore dhe është një formë diskriminimi. Ajo përfshin forma të ndryshme të dëmtimit, përfshirë dhunën fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike ose të përgjithshme [1].

Dhuna fizike në kontekstin e dhunës me bazë gjinore çon në dëmtim fizik, shqetësim dhe probleme shëndetësore, dhe në raste të rënda, mund të rezultojë edhe në humbje jete. Shembuj të dhunës fizike përfshijnë vepra të tilla si rrahja, ngulfatja, shtyrja dhe përdorimi i armëve. Sipas të dhënave nga Bashkimi Evropian, 31% e grave kanë hasur në një ose më shumë incidente të dhunës fizike që nga moshja 15 vjeçare [2].

Dhuna seksuale brenda sferës së dhunës me bazë gjinore përfshin vepra seksuale pa pëlqim, përpjekje për të detyruar ose për t'u përfshirë në vepra seksuale, trafikim dhe çdo veprim që cenon autonominë seksuale të një personi pa pëlqimin e saj apo tij. Është vlerësuar se afërsisht një në 20 gra (5%) në vendet e BE-së ka përjetuar përdhunim që nga moshja 15-vjeçare. [3]

Dhuna psikologjike përfshin sjellje abuzive që shkaktojnë dëme psikologjike, si kontrolli, shtrëngimi, dhuna ekonomike dhe shantazhi. Brenda Bashkimit Evropian, 43% e grave kanë përjetuar një formë të dhunës psikologjike të ushtruar nga një partner intim[4].

Dhuna ekonomike i referohet çdo veprimi ose sjelljeje që shkakton dëm financiar ose ekonomik mbi një individ. Mund të shfaqet në mënyra të ndryshme, si shkaktimi i dëmtimit të pronës së dikujt, kufizimi në qasjen e burimeve financiare, arsimit ose mundësive të punësimit, ose mospërbushja e detyrimeve financiare si alimentacioni. [5]

Dhuna me bazë gjinore, e cila veçse ishte një krizë e rëndësishme globale para pandemisë, është bërë më e rëndë që nga shpërthimi i COVID-19. Masat bllokuese dhe

[1]Komisioni Evropian. Dhuna me bazë gjinore (DHBG) sipas përkufizimit. E qasshme në: <https://commission.Evropa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/what-gender-based-violence-en>

[2] Po aty.

[3] Po aty.

[4]Po aty.

[5] Instituti Evropian për Barazi Gjinore. Dhuna ekonomike sipas definicionit. E qasshme në: https://eige.Evropa.eu/publications-resources/thesaurus/terms/1229?language_content_entity=en

kufizimet tjera në lëvizje kanë bërë që shumë gra të jenë të mbyllura me dhunuesit e tyre, të izoluar nga kontaktet shoqërore dhe sistemet e tyre mbështetëse. Rritja e pasigurisë ekonomike ka kufizuar më tej mundësinë e grave për t'iu shpëtuar situatave abuzive [6].

Duke marrë parasysh ndikimin e gjerë të dhunës me bazë gjinore në mirëqenien psikologjike, fizike dhe ekonomike të grave, është thelbësore të shqyrtohen përpjekjet e qeverive dhe akterëve kryesorë në vende të ndryshme. Përpjekjet e tyre janë thelbësore jo vetëm për trajtimin dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore si një çështje e përhapur, por edhe për të siguruar që gratë e prekura nga kjo dhunë të marrin përkrahjen dhe mbrojtjen e nevojshme që iu duhet.

Bazuar në këtë, qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptojë perceptimet e palëve të interesit në Kosovë lidhur me dhunën me bazë gjinore dhe gjininë. Studimi vlerëson shkallën e ndërjegjësimit, mirëkuptimit dhe qëndrimeve ndaj dhunës me bazë gjinore dhe gjinisë në mesin e atyre që janë përgjegjës për parandalimin e saj. Hulumtimi gjithashtu identifikon çdo pengesë ose mundësi që mund të ndikojë në efektivitetin e përpjekjeve për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

Për më tepër, studimi synon të kuptojë situatën aktuale dhe të mbledhë të dhëna të sakta për të krijuar një shoqëri të informuar që e njeh dhunën dhe diskriminimin ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut. Hulumtimi fokusohet në institucionet publike në të dy nivelet, pra lokale dhe qendrore, duke përfshirë degët legjislative dhe ekzekutive, gjyqësorin, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe organet e pavarura publike dhe bordet e tyre.

Ky studim do të shërbejë si bazë për Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) dhe Solidar Suisse SEE për të kontribuar në parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Qëllimi është zhvillimi ose zbatimi i mekanizmave të paralajmërimit të hershëm dhe ofrimi i shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarat. Ky studim ofron rekomandime praktike që promovojnë idenë se dhuna ndaj grave përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe inkurajon qytetarët të veprojnë kundër saj.

Pjesa e mëposhtme do të paraqesë një përmbledhje të gjerë të literaturës që përfshin dokumente qeveritare, literaturë akademike dhe raporte nga OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Ky rishikim fokusohet në politikat dhe hulumtimet ekzistuese që kanë të bëjnë me parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë.

Më pas, do të paraqiten gjetjet kryesore dhe analiza e të dhënave që dalin nga anketa dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Intervistat gjysmë të strukturuar janë realizuar me zyrtarët përgjegjës për dhunë dhe barazi gjinore në komunat e Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës, Gjakovës, Kamenicës dhe Gjilanit. Përveç kësaj, anketat janë realizuar me një mostër më të madhe të zyrtarëve për dhunë dhe barazi gjinore në

[6] Komisioni Evropian. Dhuna me bazë gjinore (DHBG) sipas përkufizimit. E qasshme në: https://commission.Europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/what-gender-based-violence_en [2] Po aty. [3] Po aty. [4] Po aty. [5] Instituti Evropian për Barazi Gjinore. Dhuna ekonomike sipas definicionit. E qasshme në: https://eige.Europa.eu/publications-resources/thesaurus/terms/1229?language_content_entity=en

mbarë Kosovën, si dhe një gamë më të gjerë të të anketuarve, duke përfshirë zyrtarë nga Policia e Kosovës, zyrtarë nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), përfaqësues nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), zyrtarë të tjerë komunalë ose asambleistë, deputetë të Kosovës dhe profesionistë nga Qendrat për Punë Sociale. Këto anketa synonin të vlerësonin përhapjen e perceptuar të dhunës me bazë gjinore brenda Kosovës nga përfaqësuesit/punonjësit e institucioneve publike kryesore.

Së fundi, bazuar në gjetjet e dala nga hulumtimi në tavolinë dhe të dhënat parësore, raporti përfundon me një sërë rekomandimesh në përputhje me rezultatet e hulumtimit.

Përmbledhje e literaturës

Dhuna ndaj grave është forma mbizotëruese e dhunës në familje në Kosovë siç vërtetohet nga statistikat e hulumtimeve gjinore dhe të dhënat e monitorimit të gjykatave. Në mbi 95% të rasteve, burrat janë autorë të dhunës ndaj grave apo vajzave. Për më tepër, më shumë se 90% e rasteve të dhunës në familje të analizuar në seancat gjyqësore tregojnë se shkelësit ishin plotësisht të vetëdijshëm për veprimet e tyre, duke nënkuptuar përgjegjësi penale në shumicën e rasteve [7].

Pavarësisht se dhunesit janë shpallur fajtorë për dhunë nga gjyqtarët, shpesh herë dënimi ka qenë me kusht ose me gjobë. Kjo sugjeron një lehtësim në dënimet e vendosura. Krahas dhunës në familje, gjatë vitit të kaluar ka pasur një rritje të dukshme të rasteve të raportuara të dhunës seksuale. Sipas një raporti të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), 107 raste të dhunës seksuale janë raportuar në Kosovë në vitin 2021, krahasuar me 60 raste në vitin 2020 [8]. Fatqësisht, reagimi institucional ndaj këtij trendi në rritje duket të jetë joproporcional.

Korniza ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare

Që në vitin 1992, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) pranoi se dhuna me bazë gjinore është një lloj diskriminimi që pengon përpjekjet e grave për barazi [1]. CEDAW vë theks të rëndësishëm në përgjegjësinë e shteteve për të parandaluar dhunën me bazë gjinore, si dhe për të hetuar dhe penalizuar akte të tilla. Sipas CEDAW, shtetet mbajnë përgjegjësinë për adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore që ndodhin brenda juridiksionit të tyre, duke përfshirë çdo dështim ose lëshim nga degët e tyre gjyqësore, legislative ose ekzekutive. Për më tepër, Konventa thekson rëndësinë që të gjitha shtetet të krijojnë një sistem ligjor që është efektiv dhe i qasshëm në adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore.

[7] Rrjeti i Grave të Kosovës. Shtyrja e rasteve të dhunës me bazë gjinore nga sistemi gjyqësor. (2022). E qasshme në: <https://womensnetwork.org/deferment-of-gender-based-violence-cases-by-the-judicial-system/>

[8] Po aty.

[9] Komiteti për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Rekomandimi i Përgjithshëm 19 (2011). E qasshme në: <https://d2t1lspzrjtif2.cloudfront.net/wp-content/uploads/ARTICLES-19.pdf>

Instrumenti më i fundit ndërkombëtar që trajton dhunën me bazë gjinore është Konventa e Stambollit. Qëllimi i tij kryesor është të krijojë strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për të luftuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe zbatimin e masave parandaluese, si dhe sigurimin e mbrojtjes dhe përkrahjes për të mbijetuarat. Konventa thekson gjithashtu nevojën thelbësore për t'i dhënë fund mosndëshkimit të dhunuesve në shkallë globale, duke theksuar rëndësinë e ndjekjes penale të shpejtë dhe efektive [10].

Konventa shërben si një traktat me shumë qëllime, që përfshin kodin penal, të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Ai kriminalizon në mënyrë efektive të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë abuzimin psikologjik dhe fizik, përdhunimin dhe dhunën seksuale, ndjekjen, gjymtimin gjenital femëror, sterilizimin dhe abortin e detyruar dhe martesën e detyruar.

Në rastin e Republikës së Kosovës, parimet e CEDAW janë përfshirë fuqishëm në Kushtetutën e saj përmes nenit 22 i cili citon një mori marrëveshjesh dhe instrumentesh ndërkombëtare të cilat në rast konflikti "kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike". Me fjalë të tjera, Kosova është e detyruar nga obligimet e përshkruara në CEDAW për të siguruar një kornizë ligjore efektive dhe të qasshme për të luftuar dhunën me bazë gjinore [11]. Për më tepër, Kuvendi i Republikës së Kosovës që nga viti 2020 e ka përfshirë Konventën e Stambollit (amendament nr. 26) në listën e instrumenteve ndërkombëtare përmes amendamenteve kushtetuese. Kështu që, edhe pse Kosova nuk është shtet ratifikues i Konventës së Stambollit apo anëtare e Këshillit të Evropës, Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në kornizën ligjore të Kosovës dhe ka përparësi ndaj ligjeve dhe rregulloreve të tjera [12].

Në përputhje me dispozitat e Konventës së Stambollit, në vitin 2019, Koordinatorin Nacional kundër Dhunës në Familje, në bashkëpunim me UN Women, lansuan një databazë të integruar për të gjurmuar rastet e dhunës në familje, e qasshme për institucionet relevante në sektorë të ndryshëm. Kjo bazë e të dhënave lehtëson bashkëpunimin ndërmjet ministrive dhe institucioneve, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë (MD), Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Policinë e Kosovës (PK). Gjashtë institucione, si policia, shërbimet sociale, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), strehimoret, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKP) dhe gjykata aktualisht përdorin bazën e të dhënave, me plane për përkthim në anglisht [13].

Databaza synon të ofrojë statistika anonime, duke përcjellur rrugëtimin e viktimës nëpër sistemin gjyqësor dhe shërbimet mbështetëse. Procesi përfshin futjen e të dhënave nga Policia e Kosovës, informatat për ndihmën nga shërbimet mbështetëse dhe përfundimin

[10] Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (CETS nr. 210). E qasshme në: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=210>

[11] Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008). E qasshme në: www.kryeministritks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf

[12] Konventa e Stambollit në Gjakat e Vendimeve në Kosovë. KGSC. (2022). E qasshme në: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/The-Istanbul-Convention-in-the-verdicts-of-courts-in-Kosovo_ENG.pdf

[13] Këshilli i Evropës (KE). Vlerësimi i përafërit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës* me standardet e Konventës së Stambollit. E qasshme në: <https://rm.coe.int/kosovo-assessment-report-istanbul-convention-eng/1680a9203e>

e veprave penale që lidhen me rastin nga policia, prokuroria dhe gjykatat. Megjithatë, disa sfida vazhdojnë të jenë prezente, pasi gjyqtarët nuk përpilojnë vazhdimisht të dhëna në kohë reale. Megjithëse baza e të dhënave ofron informacion të vlefshëm, delegacionit të BE-së iu dhanë vetëm të dhëna të përgjithshme për numrin e përgjithshëm të rasteve të dhunës në familje, pa detaje specifike për qasjen e viktimave në shërbimet mbështetëse dhe drejtësinë, duke penguar kështu analizën gjithëpërfshirëse të efektivitetit të sistemit nëpër sektorë dhe nxjerrjen e rregullt të statistikave gjithëpërfshirëse të Koordinatorës Nacionale. [14]

Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbështet barazinë gjinore si parim thelbësor, duke siguruar mbrojtjen e saj në nivel vendor⁸. Dhuna me bazë gjinore njihet si formë e diskriminimit sipas nenit 4 të Ligjit për Barazi Gjinore. Sipas Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë, është e detyrueshme si për subjektet publike ashtu edhe për ato private që të inkorporojnë parimin e barazisë dhe integritimit gjinor gjatë planifikimit, buxhetimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve. Kjo kërkesë shtrihet në fusha të tilla si lindja e fëmijëve dhe kompensimi. Për më tepër, ligji ndalon shprehimisht ngacmimin dhe ngacmimin seksual në të gjitha kontekstet [15].

Ligji i Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përkufizon dhunën në familje në kuadër të procedurës civile dhe përcakton kriteret për dhënien e masave mbrojtëse përmes urdhërave mbrojtës. Më tej, ai përcakton masat mbrojtëse që duhen marrë ndaj viktimës dhe bën thirrje për trajtim psiko-social ndaj autorëve të dhunës në familje.[16] Për më tepër, forma të caktuara të dhunës në familje dhe lloje të veçanta të dhunës me bazë gjinore janë kriminalizuar sipas Kodit Penal të Kosovës, duke përfshirë vepra si përdhunimi, sulmi seksual dhe abuzimi [17].

Tabela 1 Dispozitat kryesore ligjore dhe përpjekjet e Kosovës për BGJ dhe DHBGJ

Pikat kryesore dhe përpjekjet	Përshkrimi
Konventa e Stambollit (Kapitulli I)	Paraqet parimet e përgjithshme për një jetë pa dhunë, duke theksuar barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Integron perspektivën gjinore në zbatim dhe vlerësim.
Konventa e Stambollit (Fushëveprimi)	Trajton të gjitha format e dhunës ndaj grave, veçanërisht dhunën në familje që prek në mënyrë disproporcionale gratë. Përkufizimet kryesore në nenin 3 qartësojnë konceptet që lidhen me dhunën ndaj grave, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.
Konventa e Stambollit (Dhuna e motivuar nga gjinia)	Dhuna e trajtuar nga konventa është e motivuar kryesisht nga gjinia e viktimës, që rezultojnë nga marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave.

[14] Po kështu.

[15] Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore. Neni 4. (2015). E qasshme në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

[16] Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. (2010). Nenet 3-10. E qasshme në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691>

[17] Kodi nr 06/L-074. Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2019). E qasshme në: <https://md.rks.gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>

Politikat dhe Legjislati i Kosovës	Në përputhje me Konventën e Stambollit, duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026).
Përpjekjet për Kriminalizimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë	Ndryshimet në Kodin Penal (2019) dhe Ligjin për Barazinë Gjinore (2015) me qëllim të kriminalizimit të formave të ndryshme të dhunës.
Korniza ligjore për Dhunën në Familje	Mbulohet nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Kodi Penal. Ekzistojnë kufizime në kategorizimin dhe harmonizimin e Kodit Penal, duke ndikuar në njohjen e të drejtave individuale për gratë dhe vajzat që përfshijnë dhunë.
Projektligji për dhunën në familje	Synon të zëvendësojë Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, duke zgjeruar fushëveprimin dhe duke adoptuar një perspektivë të ndjeshme gjinore.
Korniza ligjore për dhunën seksuale në kohë lufte	Trajton dhunën seksuale të kohës së luftës kundër civilëve përmes Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës (2014). Ofron dëshmipërbliim dhe njohje për të mbijetuarat e abuzimit seksual dhe përdhunimit gjatë periudhës së luftës në Kosovë.
Korniza ligjore për bashkësinë jashtëmartesore	Përkufizohet si një "marrëdhënie faktike" e karakterizuar nga një jetë e përbashkët e qëndrueshme dhe e vazhdueshme sipas nenit 39 të Ligjit për Familjen. Individët konsiderohen në një bashkësi jashtëmartesore nëse kanë të drejtë të martohen, por jo të martuar ligjërisht, duke bashkëjetuar hapur si çift bashkëshortor sipas nenit 40.
Kodi Penal dhe Dhuna në Familje	Neni 248 i Kodit Penal përkufizon dhunën në familje, duke përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike, sipas nenit 2, 1.2 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.
Anëtarët e familjes dhe marrëdhëniet familjare	Neni 113 i Kodit Penal e përkufizon "anëtarin e familjes" si prindin, prindin adoptues, fëmijën, fëmijën e adoptuar, vëllanë ose motrën, bashkëshortin ose një të afërm tjetër gjaku me të cilin jetojnë. "Marrëdhënie familjare" përfshin çiftet që kanë qenë të fejuar, të martuar, në një bashkësi jashtëmartesore ose kanë pasur një fëmijë së bashku.
Mbulimi i ligjeve për dhunën në familje	Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe neni 248 i Kodit Penal nuk mbulojnë dhunën mes çifteve që nuk kanë bashkëjetuar kurrë.
Theksi në Parandalimin dhe Përkrahjen	Neni 1 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje thekson parandalimin e dhunës në familje dhe adresimin e nevojave të fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.
Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026)	Fokusohet në parandalimin, mbrojtjen, përkrahjen dhe politikat e integruara.
Strategji të tjera të ndërlidhura	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024) dhe Strategjia për Sundimin e Ligjit (2022-2026) prekin aspektin e prokurorisë, por mungojnë masat e detajuara.

Bashkëpunimi me shumë agjenci	Mekanizma të ndryshëm në nivel qendror dhe komunal promovojnë bashkëpunimin mes shumë agjencish, duke përfshirë Grupin Koordinues Ndërmintoror kundër dhunës në familje.
	Veprimtaria/Operimi është ndikuar nga vendet e hapura të Koordinatoros Nazionale kundër Dhunës në Familje
Mekanizmat Koordinues Komunal	Janë themeluar në disa komuna dhe është zgjeruar fushëveprimi për të mbuluar dhunën ndaj grave përtej dhunës në familje.
	Grupit Koordinues Ndërmintoror i mungojnë detyrat dhe burimet e përcaktuara qartë, duke penguar politikëbërjen e vazhdueshme dhe të koordinuar për të gjitha format e dhunës të mbuluara nga konventa.
Databaza e integruar për dhunën në familje	Nisur në vitin 2019, i koordinuar nga Koordinatorja Nazionale kundër Dhunës në Familje dhe i mbështetur nga UN Women.

Burimi: Përmbledhje e vetë autores bazuar në dokumentet ligjore dhe referencat e përdorura në këtë raport

Hulumtimi ekzistues mbi dhunën me bazë gjinore në Kosovë

Lloji më i përhapur i dhunës me bazë gjinore i përjetuar nga të mbijetuarat në Kosovë është dhuna në familje, e cila prek dukshëm shumë individë. Shumica e të mbijetuarave i përkasin kësaj kategorie dhe kanë lidhje familjare me dhunuesin. Shumë sugjerojnë se ky fenomen dhe pranimi i tij buron nga e drejta e zakonshme shqiptare, një dispozitë që u jepte burrave të drejtën për të ushtruar dhunë ndaj grave të tyre. Kjo përfshinte forma të ndryshme të dhunës, duke filluar nga abuzimi verbal deri tek shkaktimi i dëmtimit ose vdekjes, pa pasoja ligjore. Për më tepër, baballarët ishin të njohur gjithashtu se përdornin dhunë brutale ndaj fëmijëve të tyre [18]. Duke qenë se kjo ishte normë, rastet e dhunës në familje u përvetësuan dhe raportoheshin rrallë.

Edhe pse nuk ka një databazë zyrtare të centralizuar për përcjelljen e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, statistikat e disponueshme përmes raporteve të policisë tregojnë se në vitin 2022, janë raportuar më shumë se 2700 raste të dhunës në familje dhe nga këto raste, 2289 të mbijetuara janë identifikuar si gra. Në dy muajt e parë të vitit 2023, tashmë janë raportuar 320 raste të dhunës në familje që përfshijnë gratë [19].

Një studim nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) i kryer në vitin 2019 vlerëson se afërsisht 64% e grave të anketuara e perceptojnë dhunën nga partnerët, të njohurit ose të huajt si të zakonshme, me 27% që e konsiderojnë atë shumë të përhapur. Më shumë se gjysma (54%) e të gjitha grave raportojnë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga një partner intim që nga mosha 15 vjeçare, dhe pothuajse një e treta (29%) kanë hasur në ngacmime seksuale. Rreth 14% e grave tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale qoftë nga një partner apo jo partner (duke përjashtuar dhunën psikologjike). Në mesin e atyre që kanë pasur

[18] Maçastena A. Dhuna me bazë gjinore në Kosovë. UNHCR. (2022).

[19] Ballkan Insajti. Ndani përvojën tuaj: Dhuna në Familje në Kosovë (2023). E qasshme në: <https://balkaninsight.com/2023/03/13/share-your-experience-domestic-violence-in-kosovo/>

partnerë të mëparshëm, afërsisht 18% raportojnë se kanë hasur në dhunë fizike dhe/ose seksuale, ndërsa 9% e atyre me partnerë aktual pretendojnë dhunë nga partneri aktual [20].

Një studim tjetër kishte për qëllim vlerësimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19, duke pranuar se zbatimi i masave të karantinës e intensifikoi situatën për gratë që ishin të mbyllura në shtëpitë e tyre dhe në rrezik më të madh për të përjetuar dhunë. Ai thekson se gjatë shtatë muajve të parë të pandemisë, rastet e dhunës në familje pësuan një rritje prej 11%. Shumica e të mbijetuarave, në 80% të rasteve, ishin gra, ndërsa autorët ishin kryesisht burra të familjes, duke përfshirë bashkëshortët, ish-bashkëshortët, partnerët bashkëjetues, baballarët dhe vëllezërit [21].

Arsyet pas rritjes së dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë janë hulumtuar gjithashtu në një studim të ngjashëm. Bazuar në një anketë të kryer ndërmjet 27 korrikut dhe 23 gushtit 2020, me 908 të anketuar, studimi identifikoi faktorët kryesorë që kontribuojnë në dhunën në familje gjatë pandemisë. Këto përfshinin stresin (18.9%), pasigurinë socio-ekonomike (11.4%) dhe mungesën e hapësirës fizike për karantinë brenda shtëpisë ose banesës (4.4%). Gjithashtu, një analizë e të dhënave statistikore nga Policia e Kosovës zbuloi një rritje prej 19.75% të rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës së karantinës nga marsi deri në qershor 2020 [22].

Një raport tjetër nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) thekson një rritje të rasteve të raportuara të dhunës me bazë gjinore gjatë vitit të kaluar, si dhe një rritje të kërkesave për urdhra mbrojtëse të lëshuara nga gjykata nga viktimat. Megjithatë, viktimat e dhunës me bazë gjinore shpesh hasin pengesa gjatë raportimit të rasteve të tyre, si ndërgjegjësimi i kufizuar për të drejtat e tyre dhe shërbimet mbështetëse në dispozicion, stigma shoqërore, mungesa e besimit në institucionet shtetërore dhe kërcënimet nga dhunuesite tyre. Raporti pranon se shkeljet e konfidencialitetit, proceset burokratike dhe procedurat e gjata ligjore kontribuojnë në një mjedis dekurajues për raportimin e rasteve të dhunës në familje. Prania e normave tradicionale dhe përpjekjet për ndërmjetësim familjar midis dhunuesve dhe të mbijetuarave e ndërlikojnë më tej raportimin e dhunës me bazë gjinore dhe reagimin e mëvonshëm institucional [23].

Funksionaliteti i Mekanizmave të Paralajmërimit të Hershëm Lokal dhe Shërbimeve të Ofruara për Përkrahjen e Viktimave në Kosovë

Për të adresuar dhe trajtuar incidentet e dhunës në familje (DHF) dhe dhunës ndaj grave (DhNG), kërkohet një qasje e organizuar, bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse nga qeveria përgjegjëse dhe institucionet lokale. Aktualisht, Mekanizmat Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje (Mekanizmat Koordinues Komunal) shërbejnë si struktura të nivelit lokal që synojnë të japin një reagim të koordinuar ndaj dhunës në

[20] Mirëqenia dhe Siguria e Grave në Kosovë. Misioni i OSBE-së (2019).

[21] Limani M. dhe Limani M. Dhuna me bazë gjinore në Kosovë gjatë Pandemisë COVID-19. (2022). Gazeta Evropiane e Shkencave Sociale. E qasshme në: https://revistia.org/files/articles/ejss_v5_i2_22/Limani.pdf

[22] Gallopeni B. dhe Kamberi F. COVID-19 dhe Karantina: Treguesit e Dhunës në Familje në Kosovë. Traektorië Nauki - Rruga e Shkencës. (2020).

[23] Raporti i bazuar mbi dhunën me bazë gjinore në Kosovë: perceptimet e komunitetit dhe palëve të interesuara. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. (2022). E qasshme në: https://qkss.org/images/uploads/files/Baseline_Assessment_Eng_%281%29.pdf

familje nën autoritetin e institucioneve lokale. Që nga marsi 2023, janë themeluar 33 MKKDHf, që mbulojnë shumicën e komunave në Kosovë. Nga këto 33 MKKDHf [24], 20 u krijuan me ndihmën e drejtpërdrejtë të Misionit të OSBE-së në Kosovë, ndërsa të tjerët morën përkrahje nga Zyra e UN Women në Kosovë [25].

Mekanizmat Koordinues Komunal kanë për qëllim të rrisin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kur merren me rastet e dhunës në familje dhe të përmirësojnë reagimin institucional lokal ndaj incidenteve të tilla. Mekanizmat Koordinues Komunal përbëhen nga përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë administratën komunale, agjencitë e zbatimit të ligjit, gjyqësorin, sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, organizatat joqeveritare të grave, agjencitë e mbrojtjes së fëmijëve, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Zyra Rajonale e Punësimit, komunitetet fetare dhe partnerët e tjerë relevantë. Zhvillimi i udhëzimeve për Mekanizmat Koordinues Komunal është një hap fillestar i rëndësishëm drejt krijimit të një qasjeje të strukturuar dhe të koordinuar, duke siguruar praktika të qëndrueshme të mbledhjes së të dhënave dhe raportimit, dhe standardizimin e përpjekjeve për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për anëtarët e MKKDHf.

Përveç Mekanizmave Koordinues Komunal të krijuara së fundmi, të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë në teori kanë qasje në masa të ndryshme mbrojtëse. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton tri lloje të Urdhrave Mbrojtës, të cilat përfshijnë Urdhrat Mbrojtës, Urdhrat për Mbrojtje Emergjente të lëshuara nga gjykatat dhe Urdhrat për Mbrojtjen e Përkoshme Emergjente të lëshuara nga Policia e Kosovës jashtë orarit të rregullt të punës së gjykatës. Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen nga dhuna në familje paraqesin rolet dhe përgjegjësitë ligjore të institucioneve si Policia e Kosovës, Prokuroria, Mbrojtësit e Viktimave, Qendrat për Punë Sociale dhe Strehimoret në mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës në familje. Megjithatë, hulumtimi tregon se këto institucione shpesh luftojnë për të zbatuar në mënyrë efektive dispozitat e përcaktuara si në Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ashtu edhe në PSV [26].

Mekanizmat Koordinues Komunal janë të lidhura ngushtë me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Memorandumin përkatës të Mirëkuptimit (MM) që krijojnë çdo mekanizëm. PSV-të paraqesin protokollat dhe udhëzimet e standardizuara për trajtimin e dhunës në familje, ndërsa Mekanizmat Koordinues Komunal mbledhin së bashku përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë administratën komunale, zbatuesit e ligjit, gjyqësorin, arsimin, shëndetësinë,

[24] OSBE. Udhëzime për performancën efektive të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër dhunës në familje. (2023). Komunitet me MKKDHf janë: Gjakovë / Đakovica , Gjilan / Gnjilane , Glogoc / Glogovac , Graçanicë / Graçanicë , Hani i Elezit / Elez Han, Fushë Kosovë / Kosova Polje, Istog / Istok , Kaçanik / Kaçanik / Klokot , Klokot dhe Partesh / Partesh , Leposaviç / Leposaviq , Lipjan / Lipljan , Malishevë / Mališevo , Mamuşa / Mamushë / Mamuşa , Mitrovica / Mitrovica Veri, Mitrovica / Mitrovica Jugore, Obiliç / Obiliq , Pejë / Peć, Prishtinë ,Skenderaj/ Srbica , Suharekë /Suva Reka, Viti/Vitina, Zvečan/Zveçan, Zubin Potok, Kamenicë /Kamenica, Vushtrri / Vuçitrn . Në mars të vitit 2023, Misioni mbështeti themelimin e dy MKKDHf-ve, në komunat Novobërdë / Novobërdë dhe Ranillug / Ranillug .

[25] OSBE. Udhëzime për performancën efektive të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër dhunës në familje. (2023). E qasshme në: <https://www.osce.org/files//documents/8/0/543843.pdf>

[26] https://www.kipred.org/repository/docs/Accessing_Justice_for_Victims_of_Gender_Based_Violence_in_Kosovo_Ending_Impunity_for_Perpetrators_820425.pdf

OJQ-të, agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve, etj. Secili institucion brenda Mekanizmit Koordinues Komunal ka një përgjegjësi sektoriale të bazuar në PSV-të, duke siguruar një reagim të koordinuar dhe gjithëpërfshirës të politikave institucionale ndaj dhunës në familje. Këta mekanizma lehtësojnë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ofrojnë një platformë për takime të rregullta dhe bashkëpunim ndërmjet palëve të interesit, duke kontribuar në një qasje efektive dhe gjithëpërfshirëse në adresimin e rasteve të dhunës në familje [27].

Në përgjithësi, ka një mori akterësh të përfshirë në monitorimin dhe ofrimin e përkrahjes së viktimave për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore. Disa nga mekanizmat kryesor institucionale përfshijnë Grupin Koordinues Ndërmnistror Kundër Dhunës në Familje, Koordinatorin Nacional kundër Dhunës në Familje, Agjencinë për Barazi Gjinore, zyrat komunale, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor, Zyrën për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave, Prokurorinë e Shtetit, Gjykatat, Qendrat për Punë Sociale dhe ministrinë përkatëse. Për më tepër, partnerët mbështetës joqeveritar përfshijnë organizatat joqeveritare dhe strehimoret [28].

Për shembull, në Kosovë, ekzistojnë nëntë strehimore të krijuara posaçërisht për të ofruar një mjedis të sigurt dhe të përkohshëm jetese për të mbijetuarat e dhunës në familje. Strehimoret kanë një kapacitet të caktuar për të akomoduar gratë për një kohëzgjatje deri në gjashtë muaj [29]. Agjencia për Barazi Gjinore, që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka përcaktuar mekanizmat institucionale në Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Këto mekanizma përfshijnë strehimoret si partnere joqeveritare që luajnë një rol të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës në familje. PSV-të përshkruajnë përgjegjësitë e tyre në katër faza të reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje: identifikimi, referimi, mbrojtja dhe riintegrimi/rehabilitimi. Sipas PSV-së, strehimoret kanë një rol vendimtar si në mbrojtjen e të mbijetuarave ashtu edhe në ndihmën në riintegrimin dhe rehabilitimin e tyre në shoqëri. Atyre u kërkohet të ofrojnë një strehë të sigurt për të mbijetuarat e dhunës në familje, së bashku me shërbime shtesë si veshje, ushqim, kujdes shëndetësor dhe mjekim, këshillim dhe përkrahje psikosociale dhe ndihmë ligjore [30].

Së fundi, Kosova ka hartuar edhe një Strategji Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave për periudhën 2022-2026 për të përfshirë shtyllat e Konventës së Stambollit. Strategjia bazohet në disa parime udhëzuese. Ajo synon të përparojë drejt një qasjeje transformuese gjinore dhe të mbajë një qëndrim të zero tolerancës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Strategjia ofron një perspektivë të bazuar në të drejtat e njeriut dhe njeh rëndësinë e trajtimit të diskriminimit gjinor krahas formave të tjera të diskriminimit. Ajo vlerëson dhe respekton diversitetin dhe inkurajon koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Strategjia

[27] Po aty.

[28] Ministria e Drejtësisë. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026. (2022). E qasshme në: <https://krveministri.rks.gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf>

[29] Po aty.

[30] OSBE. Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. (2019). E qasshme në: https://www.osce.org/files/Report%20on%20Shelters%20for%20Victims%20of%20domestic%20violence%20in%20Kosovo_eng.pdf

hekson nevojën për të monitoruar progresin, ndarjen e fondeve të mjaftueshme dhe buxhetin në mënyrë efektive për zbatimin e strategjisë. Ajo vendos të mbijetuarat në qendër dhe siguron një qasje të përqendruar te viktima. Parimet e kujdesit të duhur dhe llogaridhënies mbahen gjatë gjithë zbatimit të strategjisë. Ajo adapton një qasje të ndërthortë dhe ndërsektoriale për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Për më tepër, strategjia njeht kompensimin e viktimave si një element thelbësor në sigurimin e drejtësisë së plotë, lehtësimin e shërimit dhe mundësimin e riintegritimit të suksesshëm të të mbijetuarave të prekura nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave [31].

Mangësitë ekzistuese në literaturë dhe kontributi i studimit

Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit dhe themelimin e Mekanizmave Koordinues Komunal, është thelbësore të kuptohen perspektivat e zyrtarëve përgjegjës për trajtimin e dhunës dhe promovimin e barazisë gjinore në komuna të ndryshme. Kuptimi i pikëpamjeve të tyre për Mekanizmat Koordinues Komunal ekzistues, sfidat me të cilat ballafaqohen dhe opinionet e tyre të përgjithshme për dhunën me bazë gjinore në Kosovë janë të një rëndësie të madhe.

Për më tepër, marrja e mendimeve të individëve kyç të emëruar në institucionet kyçe, duke përfshirë ministrinë dhe organet gjyqësore, është thelbësore për të vlerësuar efektivitetin e zbatimit të këtyre mekanizmave. Meqenëse asnjë e dhënë ekzistuese aktualisht nuk kap pikëpamjet e zyrtarëve për dhunën dhe barazinë gjinore dhe të palëve të tjera të interesit kur bëhet fjalë për çështjet dhe politikat e dhunës me bazë gjinore, realizimi i një studimi mbi këtë temë është i vlefshëm në identifikimin e mangësive në zbatim dhe mbledhjen e të dhënave primare. Në fund, gjetjet kryesore që rezultojnë nga ky studim mund të përdoren për të rritur efektivitetin e Mekanizmave Koordinues Komunal duke ofruar njohuri të vlefshme dhe duke adresuar fushat e identifikuara për përmirësim.

METODOLOGJIA

Ky studim ka përdorur një metodë të dyfishtë për mbledhjen e të dhënave për të marrë një kuptim gjithëpërfshirës të perceptimeve dhe nevojave të institucioneve publike në Kosovë lidhur me dhunën me bazë gjinore, si dhe për të identifikuar strategjitë e mundshme për parandalim dhe përkrahje. Hulumtimi ka përfshirë hulumtim sekondar, intervista dhe anketa, duke siguruar një analizë gjithëpërfshirëse të çështjes. Elementet kryesore të metodologjisë përfshijnë:

Hulumtimi në tavolinë:

- Një rishikim gjithëpërfshirës i politikave dhe hulumtimeve ekzistuese në lidhje me parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, duke përfshirë dokumentet qeveritare, literaturën akademike dhe raportet nga OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare.

[31] Ministria e Drejtësisë. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026. (2022). E qasshme në: <https://kryeministri.ks.gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf>

Intervistat:

- Intervista gjysmë të strukturuar me zyrtarët për barazi gjinore në komunat e Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës, Gjakovës, Kamenicës dhe Gjilanit.

Anketa:

- Realizimi i një ankete me:
 - Zyrtarët për barazi gjinore në Kosovë si dhe zyrtarët tjerë relevant që punojnë në fusha të ndërlidhura në fushën e të drejtave të njeriut dhe anëtarët e kuvendeve komunale;
 - Përfaqësuesit dhe/ose gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët policorë që janë pjesë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Policisë së Kosovës;
 - Zyrtarët përkatës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), dhe deputetë të cilët janë anëtarë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

GJETJET NGA INTERVISTAT

Kjo pjesë e raportit hedh dritë mbi gjetjet e vlefshme përmes intervistave të kryera me zyrtarë për barazi gjinore nga Prishtina, Gjilani, Kamenica, Gjakova, Mitrovica dhe Prizreni. Perspektivat e zyrtarëve u hulumtuan në fushat kryesore të mëposhtme:

1. Perceptimi dhe shkaqet e dhunës me bazë gjinore në Kosovë
2. Shpeshtësia e ballafaqimit me rastet e dhunës me bazë gjinore dhe përvojat e zyrtarëve me të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore për sa i përket lehtësisë së raportimit të tyre dhe besimit rreth konfidencialitetit
3. Pengesat me të cilat përballen të mbijetuarat që raportojnë dhunë me bazë gjinore
4. Nevojat e komunave për zbatimin efektiv të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje
5. Strategjitë efektive për parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, të nxjerra nga praktikat më të mira të vërejtura në këto komuna.

Perceptimi dhe shkaqet e dhunës me bazë gjinore në Kosovë

Të intervistuarat ishin të pajtimit se dhuna me bazë gjinore është shkelje e të drejtave themelore të njeriut. Ata shprehën mendimin se duke promovuar trajtimin e barabartë midis grave dhe burrave në shoqëri, do të ishte e mundur të eliminohej ose, së paku, të minimizohej një dhunë e tillë.

Zyrtarët identifikuan gjithashtu shkaqet e zakonshme që i atribuohen dhunës me bazë gjinore. Ato u pajtuan se dhuna në familje, e cila kryesisht ndodh brenda familjes së

ngushtë, është forma mbizotëruese e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. U theksua se kjo dhunë manifestohej në mënyra të ndryshme, duke përfshirë format e dhunës psikologjike, fizike dhe ekonomike. Për të cituar:

"Dhuna me bazë gjinore në Kosovë manifestohet kryesisht përmes dhunës fizike, psikologjike dhe ekonomike. Burrat shohin që bashkëshortja e tyre është e varur financiarisht prej tyre, gjë që u jep rrugë izolimit dhe privimit nga mjetet financiare, duke i izoluar nga shoqëria, duke e ditur shumë mirë se gruaja nuk mund t'i shpëtojë atij realiteti" (E intervistuar nga Gjakova).

Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë çështje janë identifikuar si struktura shoqërore patriarkale e Kosovës, ndryshimi i qëndrimeve kulturore ndaj roleve gjinore gjatë periudhës së tranzicionit, mungesa e edukimit mbi të drejtat e grave, traditat dhe vlerat e ngulitura kulturore, pasiguria ekonomike e grave dhe varësia nga bashkëshortët e tyre, jetesa në familje të gjera, shkalla e lartë e papunësisë dhe ndikimi i abuzimit me substancat nga burrat. Për të cituar:

"Ka shumë fakterë që kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore në Kosovë. Për shembull, të jetosh në një familje të madhe me vjehërr është një nga arsyt. Gratë mund të mos jenë në gjendje të shprehin lirish mendimin e tyre dhe ndonjëherë mendimi i tyre nuk ka rëndësi. Herë të tjera, burri mund të jetë duke përdorur substanca ose mund t'i mungojë edukimi i nevojshëm për të kuptuar barazinë e të drejtave" (E intervistuar nga Mitrovica).

"Burrat në shumë zona të vendit ende i konsiderojnë gratë pronë të tyre. Pra, në mendjen e tyre kur ushtrojnë dhunë nuk bëjnë asgjë të keqe" (E intervistuar nga Prishtina).

"Unë mendoj se një problem i madh është edhe mbështetja në traditat dhe njësitë familjare që nuk duhen thyer. Gratë janë rritur kulturalisht për të besuar se familja është hyjnore dhe koncepti i shtëpive me një prind është inekzistent" (E intervistuar nga Prizreni).

Shpeshhtësia e ballafaqimit me raste të dhunës me bazë gjinore, lehtësia e raportimit të të mbijetuarave dhe besimet e konfidencialitetit

Në përgjithësi, ka pasur perspektiva të ndryshme në lidhje me shpeshhtësinë e ballafaqimit me raste të dhunës me bazë gjinore në komuna, si dhe nivelin e besimit në aftësinë e sistemit për të siguruar anonimitetin dhe konfidencialitetin për të mbijetuarat.

Të intervistuarat u pajtuan që, në parim, zyrtarët dhe palët e tjera të interesit bëjnë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Ata angazhohen në punë në terren dhe mbajnë trajnime për të motivuar njerëzit që të paraqiten dhe të raportojnë incidentin në polici.

Megjithatë, disa të intervistuarat pranuan se pavarësisht nga ndërveprimet e tyre personale me të mbijetuarat e dhunës në familje, ato përballesh me vështirësi për t'i bindur këto gra që të denoncojnë dhunuesit në polici. Të mbijetuarat shpesh përjetojnë frikë dhe hezitim për të ndërmarrë një veprim të tillë. Të tjerat as nuk dinë se ku t'i raportojnë këto incidente. Për të cituar:

“Kam pasur kaq shumë biseda jozyrtare me gra që kanë rënë viktime të dhunës me bazë gjinore. Shumë herë jam përpjekur t'i bind të bëjnë një raport zyrtar, por rrallë e bëjnë. Arsyet për këtë janë të shumta, por më së shumti frikësohen nga pasojat, të frikësuar se si do të reagojë bashkëshorti, ndaj e durojnë atë” (E intervistuar nga Mitrovica).

“Ne kemi raste që shpesh paraqiten në zyrën tonë për të kërkuar vetëm këshilla në lidhje me hapat e raportimit. Pra, ka shumë gra që nuk janë në dijeni se çfarë hapash duhet të ndjekin kur raportojnë një rast të dhunës me bazë gjinore. Kështu që ne përpiqemi t'i këshillojmë në përputhje me rrethanat dhe t'i inkurajojmë që t'i raportojnë këto raste” (E intervistuar nga Prishtina).

Për më tepër, të intervistuarat theksuan se nga gratë kuptohet se konfidencialiteti është thelbësor në trajtimin e këtyre rasteve të ndjeshme dhe diskutimet rreth tyre nuk duhet të shtrihen përtej punës. Megjithatë, për shkak të mentalitetit kolektiv që mbizotëron në Kosovë, disa të intervistuarat përmendën se ruajtja e anonimitetit rrallë arrihet në praktikë. Informacioni tenton të përhapet përmes kanaleve joformale, duke rrezikuar pa dashje konfidencialitetin e viktimës. Personat që pranojnë raportimet i diskutojnë rastet e ditës pa dashje me miqtë, duke çuar në prishjen e anonimitetit të viktimës. Për të cituar:

“Në parim, të gjithë e dimë se anonimiteti i viktimës është kyç veçanërisht në këto raste të ndjeshme. Megjithatë, mendoj se përdoret rrallë. Në momentin që një zyrtar i përfshirë në këtë rast del nga puna, ata do t'u tregojnë miqve të tyre për rastin në punë dhe se si nuk e kishin idenë se kjo grua kishte një jetë kaq të tmerrshme familjare. Nuk e bëjnë me qëllim, mendoj. Është vetëm pjesë e kulturës sonë të flasim për çdo gjë dhe si rezultat të komprometojmë anonimitetin” (E intervistuar nga Gjilani).

Për më tepër, një e intervistuar theksoi mundësinë e ekspozimit të individëve që kryejnë akte dhune, megjithëse një ekspozim i tillë u konsiderua i përshtatshëm vetëm në rrethana të rënda. Qëllimi i kësaj qasjeje është të promovojë ndërgjegjësimin, të rrënjos një ndjenjë frike ndaj sistemit ligjor dhe të sfidojë paragykimet shoqërore. Për të cituar:

“Unë mendoj se duhet të kemi një qasje ndryshe kur bëhet fjalë për ruajtjen e konfidencialitetit. Ndonëse në parim jam dakord që të ruhet konfidencialiteti, mendoj gjithashtu se për rastet më pak të rënda ku viktime nuk lëndohet nga ekspozimi, duhet të ekspozohen rastet. Në këtë proces ne do të ndërgjegjësojmë popullatën dhe do t'i bëjmë të gjithë të vetëdijshëm se ata kanë një autor në grupin e familjes dhe/ose miqve të tyre” (E intervistuar nga Kamenica).

Pengesat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore

Zyrtaret për barazi gjinore kanë identifikuar më tej disa pengesa me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore. Një shqetësim i rëndësishëm është frika nga stigma shoqërore. Të mbijetuarat shqetësohen për pasojat negative që mund të lindin kur kuptohet se kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore. Kjo frikë nga gjykimi dhe izolimi i mundshëm mund t'i pengojë të mbijetuarat të kërkojnë ndihmë ose të raportojnë dhunën që kanë përjetuar. Për më tepër, të mbijetuarat shpesh luftojnë me pamundësinë për të dëshmuar forma të caktuara të dhunës, veçanërisht dhunën psikologjike që nuk ka dëshmi të prekshme. Kjo vështirësi në sigurimin e dëshmimeve konkrete mund të komplikojë më tej kërkimin e tyre për drejtësi dhe përkrahje.

Një tjetër pengesë me të cilën përballen të mbijetuarat është frika nga përjashtimi social dhe pamundësia për t'u riintegruar në komunitetet e tyre. Të mbijetuarat shqetësohen për izolimin ose përjashtimin nëse përvojat e tyre të dhunës me bazë gjinore bëhen publike. Frika për t'u përjashtuar nga shoqëria ose stigmatizuar mund ta bëjë të vështirë për të mbijetuarat të kërkojnë përkrahje dhe të rindërtojnë jetën e tyre pas traumës që kanë kaluar. Për më tepër, të mbijetuarat shpesh shqetësohen për sigurinë e fëmijëve të tyre dhe ruajtjen e harmonisë familjare. Ato kanë frikë nga pasojat e mundshme nga partnerët e tyre, të cilat mund të rrezikojnë mirëqenien e fëmijëve të tyre dhe të prishin marrëdhëniet familjare. Këto shqetësime sigurie mund të krijojnë një dilemë komplekse për të mbijetuarat, pasi ato duhet të marrin parasysh mirëqenien e fëmijëve të tyre krahas sigurisë së tyre.

Të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore shprehin gjithashtu mungesë besimi në sistemin e drejtësisë. Ato kanë frikë se rastet e tyre do të trajtohen në mënyrë të padrejtë nga gjykatat ose sistemi i drejtësisë, duke çuar në mungesë besimi në arritjen e drejtësisë dhe ndjenjën se përpjekjet e tyre do të jenë të kota. Kjo mungesë besimi mund t'i pengojë të mbijetuarat të kërkojnë rrugë ligjore ose të angazhohen tërësisht me sistemin e drejtësisë. Për më tepër, të mbijetuarat shpesh përjetojnë mungesë të trajtimit të duhur nga sistemi i drejtësisë, duke përfshirë mbylljen e parakohshme të rasteve, trajtim të padrejtë dhe dënime të lehta për dhunuesit. Përvoja të tilla mund të thellojnë ndjenjat e padrejtësisë së të mbijetuarave dhe të minojnë besimin e tyre në sistemin që duhet t'i mbrojtë ato.

Së fundi, varësia financiare nga dhunuesi përbën një pengesë të konsiderueshme për të mbijetuarat. Shumë të mbijetuarat përballen me vështirësi për të mbështetur veten financiarisht, gjë që shpesh i bën ato që të kthehen te i njëjti dhunues pasi kanë raportuar fillimisht dhunën. Mungesa e pavarësisë financiare dhe burimeve mund ta bëjë sfiduese për të mbijetuarat që të çlirohen nga situatat abuzive dhe të krijojnë një jetë të re pa dhunë. Mbështetja financiare dhe burimet janë thelbësore për fuqizimin e të mbijetuarave për të lënë marrëdhëniet abuzive dhe për të rindërtuar jetën e tyre. Në përgjithësi, këto pengesa përbëjnë sfidat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës

me bazë gjinore, duke e bërë më të vështirë për 'to kërkimin e ndihmës, gjetjen e sigurisë dhe arritjen e drejtësisë. Siç tha një e intervistuar:

“Në këtë vend duhet të kesh një karakter shumë të fortë për të përballuar pengesat pas raportimit të dhunës me bazë gjinore. Sidomos nëse nuk keni ndonjë pavarësi financiare, jo vetëm që do të ktheheni tek i njëjti autor, por do të jetë e vështirë të riintegrohni në shoqëri”. (E intervistuar nga Mitrovica).

Një tjetër tha:

“Ne shohim raste të dhunës në familje që trajtohen në mënyrë të padrejtë nga sistemi i drejtësisë. Autorët që dalin të lirë ose me dënime minimale për shembull. Pra, po, sigurisht që gratë dekurajohen të raportojnë incidente të tilla sepse edhe ato mund të trajtohen në mënyrë të padrejtë.” (Të intervistuar nga Prizreni).

Nevojat e komunave për të zbatuar në mënyrë efektive Mekanizmat Koordinues Komunal

Më tej, zyrtaret për barazi gjinore shpalosën një sërë nevojash që janë thelbësore për zbatimin efektiv të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje (MKKDFH) në komunitat ku ato punojnë.

Së pari, çështja e personelit adekuat dhe ndërrimit të shpeshtë të stafit u shfaq si një shqetësim kritik. Shumë komuna ballafaqohen me mungesë të stafit të mjaftueshëm ose kanë një shkallë të lartë të ndërrimit të stafit, gjë që shkakton konfuzion në lidhje me projektet në zbatim e sipër, konventat e miratuara nga Republika e Kosovës dhe barrierat ekzistuese me të cilat ballafaqohet komuna. Paqëndrueshmëria dhe mospërputhja brenda stafit minojnë funksionimin normal të Mekanizmave Koordinues Komunal dhe pengojnë ofrimin e përkrahjes gjithëpërfshirëse për të mbijetuarat.

Një tjetër temë që u shfaq është nevoja për përmirësim të infrastrukturës, veçanërisht në drejtim të automjeteve të policisë. Zyrtarët për barazi gjinore theksuan mungesën e infrastrukturës, siç është numri i pamjaftueshëm i automjeteve të policisë, gjë që pengon aftësinë e tyre për të reaguar menjëherë dhe për të kapur dhunuesit gjatë krimeve të vazhdueshme. Mungesa e burimeve dhe infrastrukturës adekuate jo vetëm që rrezikon zbatimin e ligjeve, por gjithashtu rrezikon sigurinë dhe mbrojtjen e të mbijetuarave.

Mbështetja financiare u identifikua si një kërkesë e rëndësishme për zbatim efektiv. Të intervistuarat theksuan mungesën e përkrahjes financiare, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë komunal. Edhe pse u propozua një fond kombëtar për zbatimin e Mekanizmave Koordinues Komunal, nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për krijimin e këtij fondi. Si rezultat, zyrtarët kryesisht mbështeten në donatorë ndërkombëtarë ose kombëtarë dhe vazhdimisht kërkojnë fonde për të përmbushur

aktivitetet e tyre. Kjo përkrahje në burimet e jashtme të financimit e shkurton kohën dhe devijon energjinë e tyre nga trajnimi dhe adresimi i dhunës, duke penguar efektivitetin e tyre të përgjithshëm.

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet akterëve kryesorë u shfaq si një temë tjetër thelbësore. Përveç komunave të Gjilanit dhe Prizrenit, është thënë se ka mungesë të bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesit të Mekanizmave Koordinues Komunal. Sistemi gjyqësor, duke përfshirë gjykatat dhe prokurorët, u përmendën veçanërisht si jo bashkëpunues, duke zvogëluar efektivitetin e përgjithshëm të zinxhirit të përkrahjes dhe mbrojtjes për të mbijetuarat. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet palëve të interesit pengon reagimin gjithëpërfshirës ndaj dhunës në familje dhe pengon përparimin drejt çrënjosjes së kësaj çështjeje.

Së fundi, ekzistimi i strehimoreve të përshtatshme për të mbijetuarat ishte një shqetësim urgjent i ngritur nga zyrtaret. Ato theksuan nevojën për strehimore të përshtatshme që mund të adresojnë nevojat e ndryshme të të mbijetuarave. Megjithatë, u identifikuan disa sfida, sikurse kufizimet për pranim të grave që kanë djem mbi 12 vjeç në strehimore, të cilat përjashtojnë shumë të mbijetuara që nuk dëshirojnë të lënë fëmijët e tyre pas. Gjithashtu, u përmend infrastrukture joadekuate e strehimoreve, duke theksuar kushtet e papërshtatshmetë jetesës për të mbijetuarat. Pavarësisht sigurimit të fondeve për rinovimin e strehimoreve, zbatimi i këtyre rinovimeve është vonuar. Për ta ilustruar argumentin paraprak, kështu është shprehur zyrtarja nga Gjilani për këtë çështje:

“Ne kemi strehimore, por ato nuk janë ideale. Gratë që kanë djem 12 vjeç nuk lejohen as në strehimore. E kuptoj pjesërisht arsyetimin pasi kjo bëhet edhe për të mbrojtur fëmijët që jetojnë në strehimore, veçanërisht vajzat. Megjithatë, ne nuk mund t'u ndalojmë grave hyrjen në këto strehimore vetëm sepse janë prindër të djemve më të rritur. Është e qartë se nuk mund t'i lënë, një fëmijë 12-vjeçar nuk është i aftë të jetojë në rrugë. Pra viktimave (të mbijetuarave) u ndalohet hyrja në mënyrë indirekte atëherë dhe duhet të kthehen në shtëpinë e dhunuesit” (E intervistuar nga Gjilani).

Një tjetër tha:

“Na mungon fuqia vendimmarrëse dhe kemi fonde të kufizuara sepse nuk ka fond kombëtar apo zyrtarë komunalë për këtë çështje (në shumicën e komunave) për të financuar Mekanizmin Koordinues Komunal. Ne gjithashtu kemi nevojë për një bashkëpunim më të mirë mes institucioneve mendoj, veçanërisht ndërmjet organeve të drejtësisë dhe pjesës tjetër. Sistemi gjyqësor ka fuqinë më të lartë vendimmarrëse këtu, ne të tjerët jo aq shumë” (E intervistuar nga Prishtina).

Strategjitë për Parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë - Praktikë më të mira

Zyrtaret për Barazi Gjinore theksuan më tej disa strategji kyçe për të ndihmuar në parandalimin e shfaqjes së dhunës me bazë gjinore. Një çështje e rëndësishme e ngritur nga zyrtaret është nevoja për trajnim gjithëpërfshirës. Ato theksuan rëndësinë e trajnimit të punonjësvetë rinj dhe stafit ekzistues që punojnë me dhunën me bazë gjinore, duke u siguruar që ata të kenë njohuri për konventat ekzistuese siç është Konventa e Stambollit e miratuar në Kosovë. Zyrtaret theksuan se trajnimi është thelbësor për të rritur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e këtyre konventave midis akterëve kryesorë, duke u mundësuar atyre të reagojnë në mënyrë efektive ndaj rasteve të dhunës në familje.

Një tjetër çështje e rëndësishme e përmendur nga zyrtaret është rehabilitimi dhe mbështetja për autorët e dhunës. Ata rekomanduan ofrimin e ndihmës dhe trajnimit për autorët, duke përfshirë konsultime psikologjike, për të adresuar shkaqet rrënjësore të dhunës dhe për të parandaluar përsëritjen e saj. Duke u fokusuar në rehabilitimin e autorëve, besohet se cikli i dhunës mund të prishet, duke çuar në mjedise më të sigurta për të mbijetuarat.

Zyrtaret theksuan gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit me qendrat e formimit profesional dhe zyrat e punësimit. Ata theksuan se disa komuna tashmë kanë bërë përpjekje në këtë drejtim, si Gjakova, Mitrovica, Prishtina, Prizreni dhe Gjilani. Duke u angazhuar me këto subjekte, komunat mund të ofrojnë mundësi punësimi për të mbijetuarat, duke i fuqizuar ato të shpëtojnë nga situatat abuzive dhe të bëhen të vetë-mjaftueshme.

Mbështetja financiare doli si një çështje tjetër kritike e identifikuar nga zyrtaret. Ato theksuan nevojën e dhënies së ndihmës financiare për një periudhë të caktuar për të ndihmuar të mbijetuarat të rindërtojnë jetën e tyre. Në disa komuna janë zbatuar iniciativa të tilla si mbulimi i qirasë për gjashtë muaj, mbështetja e shpenzimeve të kopshteve për fëmijët dhe ofrimi i strehimit të përhershëm për të mbijetuarat e dhunës seksuale. Zyrtaret theksuan se kjo përkrahje financiare, e kombinuar me trajnimin profesional, mund t'u mundësojë të mbijetuarave të riintegrohen në shoqëri, të rifitojnë pavarësinë dhe të çlirohen nga cikli i dhunës.

Përmirësimi i sistemit gjyqësor u theksua gjithashtu si një çështje urgjente. Zyrtaret shprehën nevojën për trajtimin e shpejtë të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dënimin e duhur për autorët e dhunës. Ata theksuan rëndësinë e një procesi gjyqësor të drejtë dhe efikas për të siguruar drejtësi për të mbijetuarat dhe për të siguruar që autorët e dhunës të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre.

Në fund, zyrtaret theksuan rëndësinë e angazhimit aktiv nga të gjitha palët kryesore të

interesit. Ato theksuan se përkundër ekzistimit të ligjeve dhe mekanizmave mbrojtës, ato shpesh zbatohen në mënyrë joadekuate. Zyrtarët kërkuar përpjekje në kohë dhe të përkushtuar nga të gjitha palët e interesit për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duke lehtësuar përfundimisht zbatimin efektiv të ligjeve dhe krijimin e një shoqërie më të barabartë dhe më mbështetëse. Më poshtë janë disa citate që ilustrjnë gjetjet e kësaj pjesë:

“Ne gjithashtu duhet të punojmë me autorët. Adresimi i qëllimeve të dhunës është thelbësor për të arritur në shkaktun themelor se përse ndodhi dhuna me bazë gjinore në radhë të parë. Autorët duhet të dërgohen në qendra rehabilitimi ose të marrin pjesë në seanca të terapisë për të kuptuar pse sillen ashtu siç sillen”
(E intervistuar nga Prizreni).

“Ne kemi nevojë për një përmirësim të sistemit gjyqësor në mënyrë që të ketë dënime adekuate për autorët. Ne duhet të kemi një angazhim më të madh të grave në të gjitha industritë në mënyrë që t'i shohim ato si shembuj, në mënyrë që ato të fuqizohen dhe të ndihmojnë për të fuqizuar pjesën tjetër që mund të mos jetë aq me fat” (E intervistuar nga Gjakova).

GJETJET E ANKETËS

Kjo pjesë e raportit paraqet gjetjet e një anketeje gjithëpërfshirëse e realizuar me palë të ndryshme të interesit të përfshira në adresimin e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) në Kosovë. Anketa përfshiu individë që përfaqësonin një sërë pozitash. Duke përmbledhur këndvështrimet dhe njohuritë e tyre, ky raport synon të hedhë dritë mbi gjendjen aktuale të reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore, të identifikojë sfidat me të cilat përballen institucione të ndryshme dhe të japë rekomandime për rritjen e përpjekjeve të tyre në luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe përkrahjen e të mbijetuarave.

Profili demografik i të anketuarve

Anketa mbi ndërgjegjësimin, përhapjen dhe nevojat institucionale për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë zbulon pjesëmarrjen e palëve të ndryshme të interesit në adresimin e kësaj çështjeje kritike. Përfaqësuesit komunalë, duke përfshirë koordinatoret për të drejtat e njeriut, zyrtarët për barazi gjinore dhe anëtarët e kuvendit komunal, përbënin një pjesë të konsiderueshme të të anketuarve, duke përfaqësuar 65% të të anketuarve në anketë. Përfaqësuesit e Qendrave për Punë Sociale përbënin 14% të të anketuarve, ndërsa zyrtarët e Policisë së Kosovës përbënin 8%. Gjyqtarët dhe prokurorët nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës morën pjesë me nga 4% secili. Deputetët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit, si dhe përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), morën pjesë me nga 2% në anketë. Këto gjetje demonstrojnë përfshirjen aktive të palëve të ndryshme të interesit në adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe theksojnë pranimin e tyre për rëndësinë e çështjes dhe nevojën për të kuptuar kërkesat institucionale në Kosovë.

Tabela 2 Ndarja e përfaqësuesve sipas institucionit

Institucioni	%
Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes i MPMS-së	2%
Agjencia për Barazi Gjinore	2%
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	4%
Këshilli Prokurorial i Kosovës	4%
Komuna	65%
Kuvendi i Kosovës	2%
Policia e Kosovës	8%
Qendra për Punë Sociale	14%
Total	100%

Nga gjithsej 51 të anketuar, 35% ishin burra, ndërsa 65% gra. Këto rezultate tregojnë një përfaqësim pak më të lartë të grave në mesin e të anketuarve në anketë, që përbën shumicën e të anketuarve.

Figura 1 Gjinia e të anketuarve





Figura më poshtë ilustron nivelin më të lartë të arsimimit të kryer nga të anketuarit, i paraqitur në përqindje. Vërehet se shumë nga të anketuarit, që përbën 49% të tyre, kishin përfunduar studimet Bachelor, gjë që tregon një pjesë të konsiderueshme të individëve me arsim universitar. Gjithashtu, 43% e të anketuarve kishin përfunduar studimet Master, duke reflektuar një prani të konsiderueshme të individëve me diploma të avancuara. Një segment më i vogël, që përbën 4%, kishte përfunduar doktoraturën ose një nivel arsimor ekuivalent, duke nënkuptuar një grup të kufizuar por të theksuar të të anketuarve me arsim të lartë. Vetëm 4% e të anketuarve kishin përfunduar arsimin e tyre në nivelin e shkollës së mesme. Këto rezultate theksojnë kualifikimet e përgjithshme më të larta arsimore të të anketuarve, me një theks të veçantë në diplomën Bachelor dhe Master, duke vërtetuar ekspertizën e të anketuarve dhe besueshmërinë e gjetjeve të anketës.

Figura 2 Niveli i përfunduar i arsimimit i të anketuarve



Perceptimi, niveli dhe shkaqet e dhunës me bazë gjinore në Kosovë

Të anketuarve iu kërkua të vlerësojnë nivelin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Shumica e të anketuarve (51%) e perceptojnë nivelin e dhunës me bazë gjinore si mesatar, ndërsa 41% e konsiderojnë atë të lartë. Vetëm një përqindje e vogël (8%) beson se niveli i dhunës me bazë gjinore në Kosovë është shumë i lartë.

Figura 3 Niveli i dhunës me bazë gjinore në Kosovë





Figura më poshtë paraqet një vlerësim gjithëpërfshirës të nivelit të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) në Kosovë bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe organizatave të ndryshme. Përfaqësuesit nga Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale njëzëri e perceptojnë nivelin e dhunës me bazë gjinore si mesatar (100%). Përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore e vlerësojnë nivelin si shumë të lartë (100%). Gjysma e përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Policisë së Kosovës e vlerësojnë se dhuna me bazë gjinore është në nivel mesatar (50%), ndërsa gjysma tjetër e vlerësojnë që kjo dhunë ekziston në nivel të lartë (50%). Ngjashëm, përfaqësuesit e Qendrave për Punë Sociale e perceptojnë nivelin si mesatar (57%) dhe të lartë (43%). Të gjithë përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës raportojnë një nivel mesatar të dhunës me bazë gjinore (100%). Përfaqësuesit e komunave tregojnë një perceptim të ndryshëm, me vlerësime të dhunës me bazë gjinore në nivel mesatar (48%), të lartë (42%) dhe shumë të lartë (9%) të dhunës me bazë gjinore. Së fundi, të gjithë përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës e vlerësojnë si të lartë nivelin e dhunës me bazë gjinore. Këto dallime theksojnë rëndësinë e


bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve për të trajtuar në mënyrë efektive dhunën me bazë gjinore në Kosovë dhe për të punuar drejt parandalimit dhe eliminimit të saj.

Figura 4 Niveli i dhunës me bazë gjinore siç perceptohet nga institucione të ndryshme



Përgjigjet e të anketuarve hedhin dritë mbi shkaqet kryesore të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) në Kosovë. Varfëria dhe pasiguria ekonomike u shfaqën si faktori më i përmendur, ku 31% e të anketuarve e identifikojnë atë si një shkak të rëndësishëm. Kjo sugjeron që pasiguria financiare e përjetuar nga individë ose familje të caktuara kontribuon në përhapjen e dhunës me bazë gjinore. Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit ishte një tjetër shkak i theksuar nga 28% e të anketuarve. Kjo tregon se mungesa e njohurive dhe mirëkuptimit për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave mund të përjetësojë sjellje dhe qëndrime të dëmshme. Qëndrimet kulturore ndaj roleve gjinore u identifikuan gjithashtu si një faktor kontribues, ku 23% e të anketuarve theksuan ndikimin e saj në dhunën me bazë gjinore. Kjo le të kuptohet se normat dhe pritshmëritë e rrënjosura thellë shoqërore ndaj gjinive të ndryshme mund të kontribuojnë në vazhdimësinë e dhunës. Për më tepër, 18% e të anketuarve identifikuan sistemet e dobëta të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit si shkak të dhunës me bazë gjinore, duke theksuar rëndësinë e një kornize ligjore efektive dhe mekanizmeve të zbatimit në adresimin dhe parandalimin e një dhune të tillë. Këto gjetje vënë në pah nevojën për qasje gjithëpërfshirëse që adresojnë faktorët themelorë socio-ekonomikë, promovojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin, sfidojnë normat e dëmshme kulturore dhe forcojnë reagimet ligjore për të luftuar në mënyrë efektive dhunën me bazë gjinore në Kosovë.

Figura 5 Shkaqet kryesore të dhunës me bazë gjinore në Kosovë



Shpeshtësia e ballafaqimit me raste të dhunës me bazë gjinore, lehtësia e raportimit të të mbijetuarave dhe besimet e konfidencialitetit

Përgjigjet e anketës në lidhje me shpeshtësinë e ballafaqimit me raste të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) në punën e të anketuarve hedhin dritë mbi përhapjen e dhunës me bazë gjinore në kontekstet e tyre përkatëse. Shumica e të anketuarve kanë raportuar se kanë hasur raste të dhunës me bazë gjinore herë pas here (39%) ose rrallë (37%), duke nënkuptuar se incidente të tilla nuk janë të përhapura vazhdimisht. Megjithatë, një përqindje e dukshme (24%) raportuan se kishin hasur shpesh raste të dhunës me bazë gjinore, duke lënë të kuptohet si një dukuri më e shpeshtë e rasteve të tilla në ambientet e tyre të punës. Sa i përket adresës fillestare të raportimit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, shumica e të anketuarve (96%) kanë treguar se të mbijetuarat zakonisht i raportojnë rastet e tyre në stacion policor. Vetëm një përqindje e vogël (4%) raportuan se të mbijetuarat fillimisht kërkojnë ndihmë nga qendrat për punë sociale.

Figura 6 Shpeshtësia e ballafaqimit me dhunën me bazë gjinore





Figura 7 Kanalet kryesore të raportimit të dhunës me bazë gjinore


Të anketuarit mendojnë se të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore përballen me sfida të rëndësishme kur bëhet fjalë për raportimin e rasteve të tyre. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (35%) e përshkruan procesin si shumë të vështirë, duke sugjeruar që të mbijetuarat hasin barriera dhe pengesa të konsiderueshme kur përpiqen të raportojnë incidentet e dhunës me bazë gjinore. Ndërkaq, 33% e të anketuarve e shihnin raportimin si deri diku të vështirë, duke theksuar më tej kompleksitetin e përfshirë. Në anën tjetër, vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve (2%) e perceptuan raportimin si shumë të lehtë, gjë që tregon se pak individë besojnë se të mbijetuarat kanë një përvojë të drejtpërdrejtë në qasjen në mekanizmat e raportimit. Pjesa e mbetur e të anketuarve futeshin te kategoria deri diku e lehtë (22%) dhe neutral (8%). Këto gjetje hedhin dritë mbi vështirësitë e perceptuara me të cilat përballen të mbijetuarat në raportimin e dhunës me bazë gjinore dhe theksojnë rëndësinë e rritjes së qasjes, efikasitetit dhe sistemeve mbështetëse për të siguruar që të mbijetuarat të jenë në gjendje të raportojnë përvojat e tyre në mënyrë efektive dhe të marrin ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme.

Figura 8 Lehtësia e raportimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore



